



SBASHK Arsimimi sot

Prill, 2026

Gazeta elektronike

Delegacioni u prit në një atmosferë shumë të ngrohtë dhe vëllazërore
Delegacioni i SBASHK-ut, i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri dhe nënkryetarja Vjollca Shala, realizoi një vizitë në Bujanoc



Një delegacion i SBASHK-ut në fillim të prillit kishte vizituar Komunën e Bujanocit. Delegacioni ishte pritur nga Kryetari i Komunës, Arbër Pajaziti, Kryetari i Kuvendit Driton Rexhepi si dhe përgjegjësi për arsim në Komunë, Agim Hasani...(faqe 4)

SBASHK në takime të rëndësishme të ETUCE-së në Bruksel



SBASHK gjatë muajit prill ka qenë pjesë e takimeve të ndryshme vendore e ndërkombëtare, ndër të cilat ka marrë pjesë në sërë takimesh të rëndësishme të organizuara nga ETUCE në Bruksel...(faqe 5)

Një aktivitet i veçantë në shërbim të anëtarësisë



Krahas shumë angazhimeve e aktiviteteve, SBASHK-u organizon tani e sa vite edhe një veprimtari të veçantë bazuar në vullnetin ...(faqe 2)

Kaçaniku kërkon digjitalizimin e shkollave, kryetari Islam Berisha premtan se do të llojë për realizimin këtyre kërkesave



Kaçaniku si komunë ka një numër relativisht të madh të punonjësve arsimor të cilët janë anëtar të SBASHK-ut...(faqe 3)

SBASHK mbajti takim me kryetarët e Nivelit Sindikal Komunal dhe të Universiteteve



SBASHK të shtunën e 18 prillit ka mbajtur takim me kryetarët e Nivelit Sindikal Komunal dhe të Universiteteve dhe Shkencës, ku ka diskutuar dhe miratuar ...(faqe 4)



Editorial

Një aktivitet i veçantë në shërbim të anëtarësisë



Krahas shumë angazhimeve e aktiviteteve, SBASHK-u organizon tani e sa vite edhe një veprimtari të veçantë bazuar në vullnetin e anëtarësisë nga të gjitha komunat e Kosovës. Çdo javë Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtarja për trajnime e komunikim, Drita Vitia Zeneli, të ndihmuar nga tërë stafi e në koordinim me kryetarët e niveleve komunale sindikale dhe me trajnerët bëjnë përgatitjet e duhura në mënyrë që trajnimet të kenë rrjedhë të mbarë. Nga kërkesat e arritura çdo javë, vërehet se trajnimi për “Aplikimin e programeve të kompjuterit në mësimdhënie” ka zgjuar interesim të lartë mes punëtorëve arsimorë dhe janë dhjetëra kërkesa e lista pjesëmarrësish që arrijnë çdo ditë pune në selinë e SBASHK-ut. Pas kësaj Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarja për trajnime komunikojnë rishtazi me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe marrin me kujdes shënimet për ambientet e mbajtjes së këtij aktiviteti dhe komunikojnë edhe me trajnerët, të cilët detyrën e tyre e kryejnë për hir të respektit ndaj

SBASHK-ut sepse pagesa për mbajtjen e një trajnimi është modeste. Ata nuk shikojnë anën materiale, por angazhohen me qëllim që trajnimi i udhëhequr nga ata të ketë rrjedhë të mbarë dhe pjesëmarrësit të fitojnë njohuri, të cilat u duhen në jetën e përditshme por edhe në procesin mësimor. Kërkesa të shumta të anëtarësisë ka edhe për trajnimin e “Forcimit të kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”. Është ky trajnim që zhvillohet në formë të bashkëbisedës dhe pjesëmarrësit marrin njohuri të shumta se si udhëhiqet dialogu në të gjitha nivelet, që nga shkolla e deri në nivelin qendror. Pjesëmarrësit bashkë me trajnerët analizojnë dhe komentojnë edhe çështje konkrete që kanë ndodhur dhe japin vlerësime se a është vepruar mirë në ato situata aktuale duke dhënë sugjerime se si duhet vepruar në situata të ndryshme, që mund të paraqiten në nivel shkolle, komune apo edhe në nivelin qendror e duke i dhënë hapësirë dhe përparësi gjithmonë dialogut. Ky trajnim përgatit kuadro për dialog në të gjitha nivelet.

SBASHK-u është në pritje të shpalljes së thirrjes nga MASH-i për të marrë pjesë edhe me programe të tjera trajnimesh dhe ato pastaj do të organizohen kudo në Kosovë në bazë të vullnetit të anëtarësisë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Bashkëbisedim

Kaçaniku kërkon digjitalizimin e shkollave, kryetari i NSKAP-it, Islam Berisha premton se do të llojë për realizimin e kërkesave të tyre



Kaçaniku si komunë ka një numër relativisht të madh të punonjësve arsimor të cilët janë anëtar të SBASHK-ut. Dita-ditës ky numër po rritet pasi ka shumë të rinj që po e marrin profesionin e mësimdhënësit, e të cilët kërkojnë të jenë pjesë e SBASHK-ut.

Megjithatë, mësimdhënësve në Kaçanik u mungon infrastruktura moderne arsimore, përfshi tabelat digjitale, apo edhe kabinetet e mjetet tjera ndihmëse të të gjitha fushave kurrikulare.

Ndërkohë, mësimdhënësit e Kaçanikut janë të interesuar për vijueshmërinë e trajnimeve që SBASHK i organizon pa pagesë për anëtarët e vet, e të cilat edhe në Kaçanik po organizohen kohë pas kohe, sikurse në çdo komunë tjetër të Kosovës.

Për këto tema dhe më shumë, mund ta lexoni intervistën e zhvilluar me kryetarin e rizgjedhur të NSKAP-it për Kaçanik, Islam Berisha.

SBASHK: Jeni rizgjedhur kryetar i Nivelit Sindikal Komunal në Kaçanik. Cili është synimi i kësaj rizgjedhjeje, cilat janë planet?

Berisha: Fillimisht shpreh falënderim dhe mirënjohje ndaj kolegeve dhe kolegëve për përkrahjen dhe besimin e dhënë në rizgjedhjen time edhe për një mandat si kryetar i NSKAP-ti në komunën e Kaçanikut. Besimi dhe

mbështetja e dhënë më obligojnë edhe më shumë që të jam në shërbim të anëtarësisë. Zotohem se do jem zëri i të gjithë anëtarësisë për të gjitha çështjet dhe do angazhohem që së bashku të mbrojmë dhe përparojmë të drejtat tona në punë, të krijojmë kushte dhe mundësi më të mira për të gjithë.

SBASHK: Çka synoni në mandatin e dytë si kryetar i NSKAP-it në Kaçanik?

Berisha: Do vazhdoj të jem zëri i fuqishëm i gjithë anëtarësisë në kërkesat e tyre. Do zhvillojmë aktivitete e takime nga afër me anëtarësinë në ngritjen dhe afirmimin e vlerave sindikale. Synojmë të përfshijmë anëtarë të rinj në SBASHK, posaqërisht punëtorët e rinj arsimorë të të gjitha niveleve. Poashtu synojmë ngritjen dhe avancimin profesional të mësimdhënësve përmes organizimit të trajnimeve nga niveli qëndror etj.

SBASHK: Cilat janë problemet të cilat i keni evidentuar gjatë mandatit të kaluar e që synoni t'i përmirësoni për anëtarësinë e Kaçanikut?

Berisha: Komuna e Kaçanikut qëndron bukur mirë me anëtarësi, por mendoj që në vazhdim të mandatit përmes takimeve më të shpeshta të afirmojmë edhe më shumë vlerat sindikale e që me siguri do rritej edhe më shumë numri i anëtarëve në komunën tonë.

SBASHK: Sa ka kërkesa për ndjekjen e trajnimeve të cilat i organizon SBASHK-u, nga anëtarësia e Kaçanikut?

Berisha: Ka pasur kërkesa të mëdha të anëtarësisë për ndjekjen e trajnimeve të cilat organizohen nga SBASHK-u. Mbi 300 anëtarë kanë ndjekur trajnimet: Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie dhe Forimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social. Ky trend i kërkesave vazhdon. Ne i jemi falënderues nivelit qëndror për mundësimin e ndjekjeve të trajnimeve dhe besojmë në organizimin e trajnimeve apo ndoshta edhe në zgjerimin e gamës të trajnimeve tjera sipas kërkesës së anëtarësisë.

SBASHK: Cilat janë kërkesat më të mëdha për përmirësimin e kushteve të punës nga punonjësit arsimor në Kaçanik?

Berisha: Meqë kushtet e punës nuk janë të dëshirueshme, kërkesat natyrshëm janë të mëdha, por primare është digjitalizimi i shkollave si dhe pajisja me kabinete e mjete ndihmëse të të gjitha fushave kurrikulare pothuajse në të gjitha shkollat e komunës tonë.

SBASHK vazhdon mbështetjen e anëtarësisë në të gjitha komunat e Kosovës.

Gjatë muajit

Delegacioni i SBASHK-ut, i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri dhe nënkryetarja Vjollca Shala, realizoi një vizitë në Bujanoc



Një delegacion i SBASHK-ut në fillim të prillit kishte vizituar Komunën e Bujanocit. Delegacioni ishte pritur nga Kryetari i Komunës, Arbër Pajaziti, Kryetari i Kuvendit Driton Rexhepi si dhe përgjegjësi për arsim në Komunë, Agim Hasani, në një atmosferë shumë të ngrohtë dhe vëllazërore. Gjatë takimit ishte diskutuar për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, shkëmbimin e përvojave sindikale dhe përfshirjen e mësimdhënësve në programet për ngritje profesionale.



Vizita kishte vazhduar në shkollën fillore “Muharrem Kadriu” në Tërmoc, ku delegacioni ishte pritur nga drejtoresha Leonora Mehmeti, kryetari i sindikatës së shkollës Diamant Hyseni dhe stafi arsimor. Në këtë takim ishte diskutuar për kushtet e punës, pagat dhe sfidat në arsim.




Po ashtu, delegacioni kishte vizituar edhe Ujësjiellësin e Bujanocit, ku ishte pritur në një atmosferë shumë miqësore. SBASHK shpreh falënderim të sinqertë për mikpritjen e jashtëzakonshme. Kjo vizitë dëshmoi edhe një herë se kjo pjesë meriton më shumë përkrahje, afërsi dhe bashkëpunim nga Kosova, si përmes ndihmave ashtu edhe përmes vizitave të ndërsjella.

Nikoqirët u ftuan për vizitë në Kosovë, me besimin se bashkëpunimi do të vazhdojë dhe do të thellohet edhe më shumë në të ardhmen.

SBASHK mbajti takim me kryetarët e Nivelit Sindikal Komunal dhe të Universiteteve



SBASHK të shtunën e 18 prillit ka mbajtur takim me kryetarët e Nivelit Sindikal Komunal dhe të Universiteteve dhe Shkencës, ku ka diskutuar dhe miratuar disa pika të rendit të ditës si: krieteret për përzgjedhjen dhe numri i anëtarëve për pushim në bregdetin shqiptar. Po ashtu është diskutuar caktimi i datave për kuvendet zgjedhore, organizimi i trajnimeve etj.



Takimin e kishte hapur kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, i cili i kishte përshëndetur të pranishmit duke i falënderuar për punën dhe përkushtimin e tyre ndaj sindikates. Jasharaj po ashtu i kishte prezantuar pikat e rendit të ditës si dhe kishte kërkuar nga kryetarët që t'i paraqesin të gjitha shqetësimet dhe qështjet që kanë të bëjnë me komunat e tyre, për të cilat kishte kërkuar të gjinden zgjidhje.




Sekretari Ymeri e kishte paraqitur edhe vendimin e SBASHK-ut dhe kriteret për dërgimin e mësimdhënësve në bregdet, të cilin SBASHK e bënë në shenjë respekti për punën dhe kontributin e tyre në arsim, e që këtë vit SBASHK pritet t'i dërgojë për pushim në bregdet rreth 400 mësimdhënës dhe staf përcjellës të shkollave.

Në takim ishte kërkuar që të respektohet kriteri i anëtarësisë si dhe kriteret tjera të caktuara nga Kryesia e

SBASHK në takime të rëndësishme të ETUCE-së në Bruksel



SBASHK gjatë muajit prill ka qenë pjesë e takimeve të ndryshme vendore e ndërkombëtare, ndër të cilat ka marrë pjesë në sërë takimesh të rëndësishme të organizuara nga ETUCE në Bruksel, duke përfaqësuar interesat e punëtorëve të arsimit nga Kosova në nivel evropian dhe duke forcuar bashkëpunimin me sindikatat homologe.



Në këto aktivitete, SBASHK është përfaqësuar nga Vjollca Shala, Nënkryetare e SBASHK-ut, si dhe nga Ymer Ymeri, Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut. Fillimisht, në kuadër të European ComNet Meeting, SBASHK ishte përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, z. Ymer Ymeri. Ky takim i rëndësishëm i rrjetit të komunikimit sindikal u hap nga Sekretari i Përgjithshëm i Education International, David Edwards, i cili prezantoi prioritetet kryesore të planit strategjik global.



SBASHK-ut.

Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, e kishte paraqitur punën e SBASHK-ut në fushën e bashkëpunimeve ndërkombëtare ku kishte treguar për planet e pjesëmarrjes së SBASHK-ut në takimet e Sindikatave Evropiane dhe Botërore të Arsimit.

Po ashtu në takim ishte diskutuar kërkesa e anëtarëve të SBASHK-ut për ndjekjen e trajnimeve për mësimdhënës të cilat i organizon SBASHK-u si dhe organizimi i mirëfillt tyre. Kryetarët e NSKAP-eve kishin paraqitur kërkesën e madhe të mësimdhënësve për vijimin e trajnimeve.

Si pikë të rendit të ditës SBASHK e kishte diskutuar edhe për caktimin e datave për mbajtjen e Kuvendeve zgjedhore në disa komuna.



Në fjalën e tij u theksua se arsimi publik cilësor për të gjithë mbetet themeli i veprimit sindikal, ndërsa sfidat globale si mungesa e mësuesve, financimi i pamjaftueshëm dhe ndikimi i zhvillimeve teknologjike kërkojnë angazhim më të madh dhe qasje të koordinuar. Ai nënvizoi gjithashtu rëndësinë e forcimit të profesionit të mësuesit, mbrojtjes së demokracisë dhe të drejtave të njeriut, si dhe rolin kyç të sindikatave në ndërtimin e narrativave publike dhe përballimin e dezinformimit.



Gjatë këtij takimi, u diskutua edhe për fushatat globale të arsimit publik, përvojat e ndryshme të sindikatave në komunikim dhe rëndësia e solidaritetit ndërkombëtar në avancimin e çështjeve të arsimit.

Në Komitetin e ETUCE-së, SBASHK ishte përfaqësuar nga znj. Vjollca Shala, në cilësinë e anëtares së këtij Komiteti dhe përfaqësuese e Kosovës, ku ishin trajtuar çështje strategjike që lidhen me politikat arsimore evropiane, Agjendën e BE-së për Mësuesit dhe vendimmarrje të rëndësishme organizative.

Po ashtu, znj. Shala kishte marrë pjesë edhe në Komitetin për Barazi (Statusin e Grave) të ETUCE-së, ku fokusi

ishte në avancimin e barazisë gjinore në arsim, strategjitë për vitet 2026–2030, eliminimin e pabarazive në paga dhe fuqizimin e rolit të grave në vendimmarrje.

Pjesëmarrja aktive e SBASHK-ut në këto forume dëshmon përkushtimin për të qenë pjesë e zhvillimeve evropiane dhe ndërkombëtare në arsim, duke siguruar që zëri i punëtorëve të arsimit nga Kosova të jetë i përfaqësuar denjësisht në këto procese të rëndësishme.

SBASHK vizitoi Komunën e Kaçanikut, organizoi edhe kuvendin zgjedhor të SBASHK-ut në këtë komunë



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj i shoqëruar nga zyrtari Ligjor, Blendor Shatri, kryetari i Nivelit Sindikal Komunal, Islam Berisha dhe anëtarja e kryesisë, Hanife Shorra, para se të mbahej Kuvendi zgjedhor, kishin vizituar Kuvendin Komunal dhe ishin pritur nga kryetari, Sabedin Vishi dhe nënkryetari Xhelal Dema.



Jasharaj kishte përgëzuar kryetarin Vishi duke i dëshiruar shumë arritje e suksese të reja. Kryetari i Kaçanikut Vishi kishte vlerësuar lartë angazhimet e SBASHK-ut dhe ishte shprehur se do të vazhdojë bashkëpunimin me SBASHK-un në shërbim të arsimit në këtë komunë.

Pas kësaj ishte mbajtur Kuvendi zgjedhor.



Kryetari Jasharaj kishte falënderuar pjesëmarrësit për angazhimet dhe unitetin gjatë gjithë këtyre viteve duke shprehur respekt për angazhimet e kryetarit Berisha. Në këtë Kuvend zgjedhor pjesëmarrësit me votën e tyre kanë rizgjedhur për kryetar Islam Berishën.



Edhe në këtë Kuvend Zgjedhor, Blendor Shatri u propozua për kryetar të SBASHK-ut kurse Ymer Ymerit u propozua t'i vazhdohet edhe një mandat si Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.

Në emër të shkollës “Emin Duraku” nga njëra anë dhe nga ana tjetër në emër të Nivelit Komunal Sindikal të Kaçanikut, iu ndanë mirënjohje kryetarit Jasharaj për angazhimet në shërbim të anëtarësisë.

Zgjedhjet Sindikale në Gjilan – Kryetar u rizgjodh Blerim Mehmeti, ndërsa nënkryetare Ibadete Limoni



Në Gjilan u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku u zgjodhën kryetari, nënkryetarja, kryesia e re e NSKAP-it të Gjilanit, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Gjatë procesit zgjedhor në Gjilan ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rahman Jasharaj dhe Kryetari i Komisionit Statutar, Blendor Shatri. Procesi zgjedhor në Gjilan u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kryetar i

NSKAP-it të Gjilanit u rizgjodh Blerim Mehmeti, ndërsa nënkryetare, Ibadete Limoni.



Kuvendi i NSKAP-it të Gjilanit i propozoi Kongresit

Gjakova mbajti Kuvend pune, kurse Shoqata Sindikale “Lorenc Anotni” në Prizren zgjodhi udhëheqësinë e re



Të enjten e 24 majit në Gjakovë ishte mbajtur një kuvend pune, ku ishin propozuar edhe kandidatët për kryetar të Nivelit Sindikal Komunal të kësaj komune. Në Kuvend, pjesëmarrës ishin edhe udhëheqës të lartë të SBASHK-ut, kryetari Rrahman Jasharaj dhe kryetari i Komisionit Statutar, Blendor Shatri.



Kryetari Jasharaj i uroi punime të mbara këtij kuvendi e po ashtu edhe zgjedhjeve të Nivelit Sindikal Komunal në përgjithësi të cilat u mbajtën në vazhdim. Në këtë Kuvend pune u propozuan edhe kandidatët për kryetar të NSKAP-it për Gjakovë: Arben Sufaj, Visar Shehu dhe Fidan Shala.

të SBASHK-ut që Rrahman Jasharaj të shpallet kryetar nderi. Kurse propozoi kandidaturën e z. Blendor Shatrit për Kryetar të SBASHK-ut si dhe propozoi që z. Ymer Ymeri t'i vazhdohet edhe një mandat si Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.

Ky kuvend u organizua në kuadër të zgjedhjeve të rregullta, të cilat ishin shpallur në vitin 2025 dhe ishin mbajtur në të gjitha shoqatat sindikale, për të vazhduar edhe në të gjitha nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut.



Të pranishmit me një fjalë rasti i përshëndeti kryetari aktual i NSKAP-it për Gjakovë, Zenun Nimani, i cili pjesëmarrësve u dëshiroi kuvend të mbarë të punës. Kurse në Prizren të enjten ishte organizuar Kuvend Zgjedhor në Shoqatën Sindikale “Lorenc Antoni”, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri.



Procesi zgjedhor në Shoqatën Sindikale “Lorenc Antoni” ishte zhvilluar në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë ku kryetare ishte zgjedh Albana Spahiu kurse nënkryetar Niman Gega si dhe ishin zgjedhë anëtarët e kryesisë së Shoqatës.

Ky kuvend u organizua në kuadër të zgjedhjeve të rregullta, të cilat ishin shpallur në vitin 2025 dhe ishin mbajtur në të gjitha shoqatat sindikale, për të vazhduar edhe në të gjitha nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut.

Lipjani mbajti Kuvend pune



Në fillimprill në Lipjan ishte mbajtur një kuvend i punës, ku ishin propozuar edhe kandidatët për kryetar të Nivelit Sindikal Komunal të kësaj komune.



Në Kuvend pjesëmarrës ishin edhe udhëheqës të lartë të SBASHK-ut, kryetari Rrahman Jasharaj, sekretari Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe kryetari i Komisionit Statutar, Blendor Shatri.




Kryetari Jasharaj i uroi punime të mbara këtij kuvendi e po ashtu edhe zgjedhjeve të Nivelit Sindikal Komunal në përgjithësi të cilat ishin mbajtur në vazhdim.

Në këtë Kuvend pune u propozuan edhe kandidatët për kryetar të NSKAP-it për Lipjan: Nexhat Gashi, Valbona Kryeziu, Artan Buja, Lutfije Ibrahim, Mirlinda Sahiti, Artan Hasani. Po ashtu, në këtë Kuvend Pune ishte propozuar edhe Blendor Shatri për kryetar të SBASHK-ut.

Të pranishmit me një fjalë rasti i kishte përshëndetur kryetari aktual i NSKAP-it për Lipjan, Emrush Ahmeti, i cili të pranishmëve u kishte dëshiruar kuvend të mbarë të punës.

Trajnimet

SBASHK gjatë muajit prill ka organizuar një varg trajnimesh për mësimdhënës në shumë komuna të Kosovës
Vikendin e fundit të prillit SBASHK mbajti testin në Obiliq për një grup të mësimdhënësve



Të shtunën e 25 prillit SBASHK organizoi testin për një grup të mësimdhënësve në Obiliq, të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.



Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi.



Mësimdhënësit po ashtu i kishte vizituar kryetarja e NSKAP-it për Obiliq, Luljeta Boshnjaku, e cila ishte kujdes për mbarëvajtjen e testimit, ndërsa trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Xhelal Krasniqi.

Ndërkohë, në po të njëjtin vikend, SBASHK kishte filluar edhe me katër grupe të trajnimit, dy në Prishtinë dhe dy grupe në Dragash.



Në Prishtinë kishin filluar dy grupe në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, një në modulën e parë dhe një në modulën e dytë, të cilët po udhëhiqen nga trajnerët Nexhmedin Gruda, respektivisht Dorentinë Demaku.



Mësimdhënësit të cilët e kishin filluar trajnimin i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini, i cili ishte kujdes për mbarëvajtjen e trajnimit.



Kurse në Dragash kishin filluar dy grupe të trajnimit, njëri në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, moduli 2 si dhe një grup i trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, i cili ishte udhëhequr nga trajneri Vloran Krasniqi.



Ndërkohë, tri grupet e trajnimit që po zhvilloheshin në Mitrovicë, i kishte vizituar udhëheqësi i divizionit për Licencimin e Mësimdhënësve në MASH, Osman Beka. Kurse dy grupet e trajnimit të cilat filluan në Prishtinë, i vizitoi Luan Sahitaj, zyrtar i lartë për zhvillim profesional dhe licencim të personelit arsimor në MASH.



Disa ditë më parë, SBASHK kishte mbajtur testet për dy grupe të mësimdhënësve në Skenderaj të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.



Testet ishin administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi.



Ndërsa, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Skenderaj, Shpend Rexha, i cili ishte kujdes për mbarëvajtjen e testit. Ndërkohë, trajnimet ishin udhëhequr nga trajneret e përcaktuara nga SBASHK, Arbenita Gashi dhe Fatlume Mehmeti.

Paraprakisht, SBASHK kishte organizuar testin në Viti, kurse në Gjilan e Rahovec kishin filluar edhe dy grupe të reja të trajnimit.


Të dielën e 19 prillit në Viti, SBASHK e kishte organizuar testin për një grup të mësimdhënësve të cilët e kishin përfunduar trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie-moduli2”.





Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, derisa për tu kujdesur për mbarëvajtjen e testimit, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Viti, Kemajl Bislmi dhe kryetarja e zgjedhur, Makfirete Zuka.



Gjatë testimit, mësimdhënësit i kishte vizituar edhe drejtoresha e DKA-së në Viti, Arta Alidema Ajeti. Kurse, trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Musli Neziri. Po ashtu, të dielën SBASHK i kishte filluar edhe dy grupe të reja të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, një në Gjilan, nën udhëheqjen e trajneres Ibadete Limoni, dhe një grup në Rahovec, nën udhëheqjen e trajneres Albana Duraku.



Ndërsa, kërkesa më e madhe për fillimin e tranimeve ishte vikendi i 18 dhe 19 prillit, ku menjëherë pas përfundimit të pushimit pranveror, mësimdhënësit kishin shprehur interesim për vijimin e trajnimeve të cilat u nevojiten për licencë e që SBASHK i organizon falas për anëtarësinë e vet.



Të shtunën e 18 prillit SBASHK kishte filluar me 15 grupe të trajnimit në dy programe të ndryshme të trajnimit: Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie dhe Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social.



Në Ferizaj kishin filluar katër grupe të trajnimit, dy në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerët Arsim Qalaj dhe Xhemil Halili si dhe dy grupe në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK, Emrush Ahmeti dhe Bashkim Hyseni.




Mësimdhënësit të cilët e kishin filluar trajnimin i kishte vizituar edhe anëtar i kryesisë së SBASHK-ut në Ferizaj, Arben Xhokli, i cili u kujdes për fillim të mbarë dhe mbarëvajtjen e trajnimeve.




Po ashtu në Podujevë SBASHK kishte filluar të shtunën me 4 grupe të trajnimit, dy në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK, Blerim Hyseni dhe Leutrim Sadiku si dhe dy grupe në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajnerët Afrim Gashi dhe Nora Haliti.

Edhe mësimdhënësit e Podujevës i kishte vizituar kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Fadil Halimi, i cili mësimdhënësve u dëshiroi arritje sa më të larta profesionale.



SBASHK të shtunën e 18 prillit kishte filluar edhe me tri grupe të trajnimit në Mitrovicë, një në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”-moduli 1 me trajner Kadri Hyseni, një grup në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”-moduli 2 me trajner Fevzi Selmani si dhe një grup në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me trajneren e përcaktuar nga SBASHK, Lindita Muja.



Për t'u kujdesur për mbarëvajtjen e trajnimit si dhe kushtet e punës së mësimdhënësve, trajnimet e filluara i kishte vizituar kryetari i NSKAP-it për Mitrovicë, Isa Ismajli i cili u kishte dëshiruar sukses dhe punë të mbarë mësimdhënësve.

Ndërkohë në Rahovec SBASHK e kishte filluar një grup të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnere Albana Duraku, derisa të dielën kishte vazhduar me grupin e dytë të trajnimit në po të njëjtin program i cili ishte udhëhequr nga e njëjta trajnere.

Edhe në Gjilan kishte filluar një grup i trajnimit të shtunën dhe i dyti të dielën në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, të cilat po udhëhiqen paralelisht nga trajnerja Ibadete Limoni.



Kurse në Istog filloi një grup i trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Burim Krasniqi, kurse në Junik filloi një grup i trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Ilir Gashi.

Të gjitha trajnimet po organizohen nga SBASHK për anëtarët e vet pa pagesë, derisa vazhdon mbështetja për anëtarësinë në përgatitjet profesionale dhe ngritje të cilësisë së arsimit.

Zgjedhjet Sindikale në Mitrovicë – Kryetar u rizgjodh Isa Ismajli, ndërsa nënkryetare Lindita Muja



Në Mitrovicë u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku u zgjodhën kryetari, nënkryetarja, kryesia e re e NSKAP-it të Mitrovicës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

Gjatë procesit zgjedhor në Mitrovicë ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe Kryetari i komisionit statutar, Blendor Shatri. Procesi zgjedhor në Mitrovicë u zhvillua



në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kryetar i NSKAP-it të Mitrovicës u rizgjodh Isa Ismajli, ndërsa nënkryetare, Lindita Muja.

Ky kuvend u organizua në kuadër të zgjedhjeve të rregullta, të cilat ishin shpallur në vitin 2025 dhe ishin mbajtur në të gjitha shoqatat sindikale, për të vazhduar edhe në të gjitha nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut.